



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO**

**KOMUNA SHTIME/ OPSTINA-STIMLJE/ MUNICIPALITY OF SHTIME
ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PREDSEDNIKA/MAYOR'S OFFICE**

26.09.2023

Nr. i Protokollit: 02/ 838

**Procesverbal nga dëgjimi publik me qytetarë për projekt buxhetin e vitit
2024, i organizuar nga Komiteti për Politikë dhe Financa në bashkëpunim me
Zyrën për Informim**

E mërkurë, më 22 shtator 2023

Kohëzgjatja e takimit: 18:00 –19:40

Vendi i takimit: Salla e Kuvendit

Pjesëmarrës në takim: Kryetari i Komunës – Qemajl Aliu, Kryesuesi i Kuvendit - Adnan Ademi, Drejtori i Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi - Grejtalb Emini; Drejtoresha e Arsimit – Yllka Fejzullahu, Drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport – Albana Fazliu, Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike – Bardhyl Rushiti dhe Zyrtari i Lart Financiar – Bujar Ferati.

Rendi i ditës:

1.Draft-Plani Buxhetor Komunal për periudhën 2024-2026

Qemajl Aliu – Kryetar i Komunës: Përshëndetje për të gjithë ju qytetarë që jeni sot prezent, përshëndetje për bashkëpunorët, Drejtorët, Kryesues, zyrtarët prej zyrës së financave, faleminderit shumë që ju keni përgjigjur ftesës sonë për këtë dëgjim publik.

Në kornizën e parë buxhetore kemi pasur mundësi dhe kohë të shkojmë në secilin vendbanim dhe t'i marrim kërkesat edhe nevojat e qytetarëve për të hartuar buxhetin për vitin 2024, ndërsa në kornizën e dytë buxhetore pak para se të draftohet ne kemi ftuar dy dëgjime publike, ku dje kemi mbatur njërin dhe sot është i dyti. Gjejë rastin të ju falënderoj secilin prej jush veç e veç për kohën dhe mundin që keni marrë që të vini në këtë dëgjim publik, që bashkë të bisedojmë dhe të marrim kërkesat dhe nevojat e juaja.

Prezenca sa më masovike e qytetarëve në këto dëgjime publike na len të kuptojmë që ne në qeverisje nuk jemi vetëm dhe punët e mira dhe rrugën parimore që jemi zotuar dhe që po e ndjekim gjithmonë nga pas jemi me qytetarët.

Sot ne jemi këtu për të dëgjuar zërin e juaj, kërkesat e juaja, shqetësimet dhe propozimet e juaja, jemi edhe me stafin qeverisës me drejtorat e fushave të ndryshme, ku pastaj secila kërkesë do të ju adresohet dikastereve.

Ju e dini që buxheti është njëri nga projektet më të rëndësishme që prodhon qeverisja lokale edhe buxheti vjetor është ai program i cili përfshinë të gjitha zhvillimet në të gjitha sferat, kështu që draftimi i buxhetit fillon prej kornizës së parë diku nga muaji qershor dhe muaji shtator është faza

e fundit ku bëhen propozimet e fundit, ato që në fazat paraprake nuk kanë pasur mundësi të adresohen.

Në pika të shkurtëra, buxheti i komunës së Shtimes këtë vit është diku afër 10 milion euro, fal edhe rritjes që ka ndodhur këto dy vitet që jemi në qeverisje. Domethënë ne e kemi gjetur dikun rreth 7.8 ndërsa tani jemi përafërsisht 10 milion, pothuajse çdo vit nga 1 deri në 1.8 milion është rritur, kjo si reflektim i qeverisjes së mirë në nivel republikan dhe mbledhjes dhe menaxhimit të taksave në mënyrë efikase, ku si rezultat është rritur buxheti i shtetit dhe i të gjitha komunave.

Në pika të shkurtëra diku rreth 50% e buxhetit shkon për paga dhe mëditje në sektorin publik, pastaj pjesa tjetër ndahet në investime kapitale, ku dallim prej viteve të kaluara kemi ngritje edhe në këtë sektor, ku do të kemi mundësi që brenda vitit 2024 të implementojmë projekte infrastrukturore në vlerë dikun 2.5 deri në 2.6 milion. Si dhe pjesa tjetër ku janë subvencionet, mallrat dhe shërbimet, ku në mënyrë më të detajuar për ju mund të flas zyrtari kryesor financiar, Bujar Ferati.

Unë nuk e kisha zgjatë më shumë, fjalën ua kisha kaluar juve, ku keni të drejt t'i ngrisni kërkesat, shqetësimet, nevojat por edhe idet e juaja. Ju faleminderit edhe njëherë.

Bujar Ferati – Zyrtari Kryesor Financiar : Përshëndetje për të gjithë qytetarët e Komunës, njëherëshit ju falënderoj për pjesëmarrjen në këtë takim i cili është i një rëndësie shumë të veçant për drejtimin e buxhetit të ardhshëm të Komunës tonë. Shkurtimisht do të jem para juve me një prezentim shumë të shkurtër pasi që shumicën e atyre që u deshën të thuheshin i tha Kryetari i Komunës. Tani më ne jemi në fazën e fundit dhe presim prej juve të na jepni sygjerime dhe ndonjë ide për projektet që i nevojiten komunës tonë.

Unë isha ndal vetëm në disa pika të shkurtëra që t'i prezentojë disa numra dhe shifra të cilat janë shumë të rëndësishme.

Total buxheti është 9.906.819 euro, që në raport me vitin e kaluar është rritur për 1.150.779 euro, domethënë kemi buxhet pak më të rritur se në vitin e kaluar.

Struktura buxhetore u tha më herët, ku pjesa më e madhe e buxhetit për vitin 2024 shkon për kategorinë e pagave 5.604.111, kurse në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve 1.133.279, shpenzimet komunale 220.000, subvencionet 350.000.

Nëse ndonjëri prej jush ka ndonjë pyetje apo diçka ne mund të japim edhe sqarime më në detaje, përndryshe unë po ja jap fjalën Drejtorit të Urbanizmit, Grejtalb Eminit që mundësisht së paku t'i përmend projektet të cilat janë projekt për këtë vit, por nëse ka nevojë edhe projektet të cilat janë duke u zhvilluar e që kanë qenë në proces për dy vitet edhe atë 23 dhe 24, por edhe projektet të cilat janë për 2024 e që janë projekte të reja që kanë buruar nga kërkesat e qytetarëve.

Edhe njëherë ju falënderoj shumë dhe po i'a jap fjalën Drejtorit Emini.

Grejtalb Emini – Drejtor për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi: Faleminderit Bujar, përshëndetje për të gjithë, shumicën e fjalëve i tha Bujari dhe Kryetari. Ne i kemi përgaditur projektet për investimet kapitale, drejtorja për planifikim urban, kadastër dhe gjeodezi, ka 22 projekte të reja pa i përfshirë edhe projektet që janë 2 vjeçare, gjithsej janë 2.5 milion në investime kapitale, që përfshihen të gjitha drejtorit, ku shumicën e investimeve kapitale i ka drejtorja e planifikimit urban.

Ne në qarkoren e parë, siç e tha edhe kryetari kemi qenë në secilin fshat dhe i kemi marr kërkesat, mirëpo ka pasur mundësi që dikush ska pas kohë të jetë në ato takime prandaj është mirë që të shfrytëzohet sot ky takim dhe të paraqiten kërkesat. Nuk mund të bëjmë ndryshe të mëdha për

shkak të kufive buxhetor të cilat Bujari vetëm sa i potencoi. E rëndësishme është se secili fshat është i përfshirë në buxhetin e komunës, në secilin fshat ka investim. Ne jemi të hapur për çdo kërkesë të cilën ju e keni kështu që mos na kurseni. Ju faleminderit!

Kërkesat e qytetarëve :

- **Brahim Isufaj:** Trotuari të rregullohet tek shkolla në fshatin Molopolc. Rruga e “Neredimes”, duhet të ketë investime më shumë, të ketë shenjëzim të objekteve që janë përdorur gjatë luftës nga Zona Operative e Nerodimes dhe të vendosen pllaka që do të tregonin se çka ka ndodhur e çfarë është bërë në këtë zonë gjatë luftës së fundit. Po ashtu kërkoj të investohet në Sheshin e Flamurit, i cili ka vlera historike dhe ku mund të shfrytëzohet nga banorët e fshatit për rekreacion.
- **Agim Hysenaj:** Rregullimi i ndriçimit tek “Luzhakët”, dhe të bëhet trotuari tek lagjia “Hysenaj”. Janë disa shtëpi rreth varrezave të cilat janë pa kanalizim, mundësisht të kyçen në rrjedhën e kanalizimit, dikun gjatësia 450 metra.
- **Qlirimtar Misini:** Të rregullohet shtrati i lumit në Godanc.
Dy mbrojtëse në fillim të fshatit Godanc tek lumi të rregullohen. Po ashtu edhe një kërkesë për Drejtorin e Urbanizmit, tek rruga “Gashi” është një pjesë e shkurtër që të lidhet me tranzit, nëse ka mundësi të rregullohet.
- **Violeta Hysenaj:** Të rregullohet kanalizimi si dhe të vendoset një dritë në rrugën “Ahmet Shtimja”, përkatësisht në hyrje të rrugës që të çon te Salla e Sportit.
- **Driton Latifi:** Kur do të fillojnë procedurat për zhvendosjen e Entit Special në Shtime?

Procesmbajtës,
Gentiana Mehmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO














KOMUNA SHTIME/ OPSTINA-STIMLJE/ MUNICIPALITY OF SHTIME

Lista e pjesëmarrësve në dëgjimin publik

Data: 22.09.2023

Nr	Emri dhe Mbiemri	Nënshkrimi
1	Edon Hasani	
2	Donjeta Gorolli	
3	NEXHAT NEZIRAJ	
4	Brezartë Ramadani	
5	KAORI GMINI	
6	Agim Hysenaj	
7	FAHRI POKA	
8	Brahim Isufaj	
9	Lulzim Schiti	
10	MUSTAFA HALILI	
11	BEKIM CANIZI	
12	Donard Ramaj	
13	Bedrije Murata	
14	SANIJE SADIKI	
15	Violeta Hysenaj	
16	AGIM MUSTAFA	
17	RAIM QAMILI	
18	BESTRIK QAMILI	
19	MUSTAFA MUSTAFA	
20	Albin Bilemi	
21	Abdullah Rushiti	
22	Halil Kurtishi	
23	Armend Hasani	

24	GEZIM HAXHIU	
25	GAFIL HOSANI	
26	ARBEN DELIU	
27	ZENOK SHABANI	
28	MENTOR SALITU	
29	LANDRIT SHABANI	
30	Metim Mustafa	
31	Shpatin Beshi	
32	Bukurije Xhemajli	
33	Bashkim Rushiti	
34	Yelber Fejzullahu	
35	Gentiana Mehmeti	
36	GLIRIMTAR MISINI	
37		
38		
39		
40		
41		
42		
43		
44		
45		
46		
47		
48		
49		
50		
51		
52		
53		





